



Në bazë të neneve 1, 5, 12, 16, 17 dhe 18 të Ligjit për çmime shtetërore dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për çmime shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 52/06, 54/07, 74/12, 99/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 98/19), Këshilli për Ndarjen e Çmimit Shtetëror "Shën Klimenti i Ohrit" në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2019 miratoi

### **V E N D I M**

për ndarjen e çmimit shtetëror "Shën Klimenti i Ohrit" në vitin 2019 për mirënjohjen më të lartë për arritjet shumëvjeçare në fushën e edukimit, arsimit, kulturës, artit, shëndetësisë, mbrojtjes dhe avancimit të mjedisit njerëzor dhe veprimtarisë sociale me interes publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut

1. Në fushën e edukimit dhe arsimit, çmimi i ndahet:

- prof. dr. Agim Poloska; albanolog

2. Në fushën e kulturës dhe artit, çmimi u ndahet:

- Dimitar Bashevski; shkrimtar  
- Vesna Gjinojska Illkova; këngëtare e operës  
- Violeta Tomovska; artiste e estradës

3. Në fushën e shëndetësisë, çmimi i ndahet:

- prof. dr. Dejan Dokiç; pulmolog - alergolog

4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

**Kryetar i Këshillit për Ndarjen e Çmimit Shtetëror  
„Shën Klimenti i Ohrit”  
akad. Vllada Urosheviç**